

VENDIM
Nr. 210, datë 16.3.2016

PËR RISHPËRNDARJEN E NUMRIT TË PUNONJËSVE NË NJËSITË E
QEVERISJES QENDRORE, PËR VITIN 2016

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 11, të ligjit nr. 147/2015, “Për buxhetin e vitit 2016”, me propozimin e ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Rishpërndarjen e numrit të punonjësve në njësitë e qeverisjes qendrore për vitin 2016, si më poshtë vijon:

a) Numri i punonjësve të Drejtorisë së Përgjithshme Detare shtohet me 20 veta, duke e çuar numrin total të punonjësve të Ministrisë së Transportit dhe Infrastrukturës në 430 punonjës;

b) Numri i punonjësve të Komitetit Shtetëror të Minoriteteve shtohet me 2 veta, duke e çuar numrin total të punonjësve të institucioneve në varësi të Kryeministrit në 328 punonjës;

c) Numri i punonjësve të aparatit të Kryeministrit shtohet me 2 veta, duke e çuar numrin total të punonjësve të institucionit të Kryeministrit në 554 punonjës;

ç) Numri i punonjësve të Ministrisë së Mbrojtjes reduktohet me 14 veta, duke e çuar numrin total të punonjësve të Ministrisë së Mbrojtjes në 9 196 punonjës;

d) Numri i punonjësve të Ministrisë së Punëve të Brendshme reduktohet me 10 veta, duke e çuar numrin total të punonjësve të Ministrisë së Punëve të Brendshme në 14 162 punonjës.

2. Rishpërndarja e numrit të punonjësve i shtrin efektet financiare dhe bëhet efektive në sistemin e thesarit pas hyrjes në fuqi të strukturës së miratuar për institucionet e përmendura në këtë vendim.

3. Ngarkohen ministritë e përmendura më sipër dhe Ministria e Financave për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTRI
Niko Peleshi